| <i>(Vulë e mëparshme e</i> <i>Bashkimit të Noterëve të</i> <i>Turqisë)</i> <i>(Fotografi e mëparshme)</i> | <p>Njëzetë e Tetë Korrik Dymijë e Gjashtëmbëdhjetë, dita e enjte 28/07/2016</p> <p>Unë Noteri i 12-të i ANKARASË, LÜTFULLAH ULUGÛN, me vulën dhe nënshkrimin e mëposhtëm, teksa ushtroja detyrën në zyrën time me adresë: rruga "Posta", nr: 7, kati 2, 06050 Altındağ/Ankara, mbështetur në kërkesën e ardhur për shkak të ngarkesës së tij në punë u paraqita në adresën e referuar: MILLI EĞİTİM BAKANLIĞI KIZILAY, ANKARA, në të cilën i interesuari ISMET YILMAZ, i cili sipas letërnjoftimit me fotografi me datë 31.05.2016, numër regjistri 18783, numër serial T13 dhe me numër 898633, lëshuar nga Drejtoria e Gjendjes Civile të Çankaya, është i regjistruar me gjendje civile në qytetin Sivas, komuna Gürün, lagjia/fshati Güneş, vëllimi 39, numër rendor familjar 10, numër rendor personal 59, me atësi Ibrahim, me amësi Turuç, i datëlindjes 10.12.1961, me vendlindje Güneş, me numër ID-je në Republikën e Turqisë 39089051016, aktualisht me vendbanim në adresën: lagjia "Kazım Özalp", rrugica "Kelebek", nr. 23, Çankaya/ANKARA, i cili deklaron se është i arsimuar, më kërkoi hartimin AKTIT TË THEMELIMIT TË FONDACIONIT NË FORMËN E REDAKTIMIT. Pasi u noha mbi identitetin e të interesuarit referuar dokumentit të referuar më lart, kuptova se ka zotësinë për të kryer këtë procedurë dhe se i interesuari ISMET YILMAZ është i arsimuar. I interesuari, MINISTRI I ARSIMIT KOMBËTAR ISMET YILMAZ, i cili vepron në emër të MINISTRISË TË ARSIMIT KOMBËTAR nisi deklarimin me këto fjalë:</p> <p style="text-align: right;"><i>(Vulë-Nënshkrim i mëparshëm)</i> LÜTFULLAH ULUGÛN NOTERI I DYMBËDHJETË I ANKARASË <i>(Vulë e mëparshme: Nr. 20121)</i></p> <p style="text-align: right;"><i>(Vulë: Nr. 16342)</i></p> <p style="text-align: right;"><i>(Vulë-Nënshkrim)</i> <i>(Vulë: 02 Maj 2023)</i></p> <p style="text-align: right;"><i>(Vulë-Nënshkrim i mëparshëm)</i></p> <p style="text-align: right;"><i>(Vulë e mëparshme)</i></p> | |

TVSH, shpenzimet, taksa e vulës dhe kosto e letrës me vlerë janë paguar përkundrejt pajisjes me faturë.

S-2/1-2

Shkresë: 2/2 Kod: 20.4.3

NR. NBS: 201607280060012 – 4553775597


Manjola SOPOT
 Përdhlyesë Zyrtare
 e Gjyris Turky
 Cel: 0683091172



NR. THEMELTAR :2016/400
NR. VENDIMI : 2016/400

GJYKATËS : ZEKI SAĞLAM 24625
SEKRETAR : DILEK OYA KÖMÜRLÜ 99751

KËRKUES : REPUBLIKA E TURQISË, MINISTERIA E ARSIMIT KOMBËTAR
PËRFAQËSUESIT LIGJORË : Av. HAYATI CANKALOĞLU &AV. ABDULKERIM GÖKLER
Konsulenca Juridike "Iski", lagjia "Paşa", rruga "Sheshi
Yay", nr. 2, Feriköy-Şişli/STAMBOLL.

ÇËSHTJA : Fondacion (Kërkesë për regjistrimin e aktit të themelimit
të fondacionit)

DATA E ÇËSHTJES : 02/08/2016
DATA E VENDIMIT : 02/08/2016
DATA E PËRPILIMIT TË VENDIMIT : 02/08/2016

Në përfundim të gjykimit të hapur të çështjes së Fondacionit (Kërkesë për regjistrimin e aktit të themelimit) që po zhvillohet në gjykatën tonë,

U ARSYETUA SE:

Përfaqësuesi ligjor i kërkuesit në mënyrë të përmbledhur ka kërkuar dhe ka paraqitur në kërkesë padë: Me ligjin datë 17.06.2016 dhe numër 6721 është rregulluar themelimi i Fondacionit Turk Maarif, në kuadër të detyrës dhe autoritetit të dhënë në përputhje me ligjin nr. 6721, akti zyrtar i themelimit i Fondacionit Turk Maarif është përgatitur dhe miratuar nga Noteri i 12-të i Ankarasë me numër repertitori 26964 dhe datë 28.07.2016, pas zbritjes së shpenzimeve të bëra për themelimin e Fondacionit Turk Maarif, pjesa e mbetur prej 990.000.00 TL (nëntëqind e nëntëdhjetë e një mijë lira turke) është bllokuar në llogarinë numër 00158007304895503 në Bankën e Fondacioneve Turke, në emër të Fondacionit Turk Maarif, kanë dorëzuar një kopje të dëftesës bankare si shtojcë e kërkesës, me qëllim që Fondacioni Turk Maarif të fitojë personalitet juridik, me pranimin e padisë të merret vendimi për regjistrimin e aktin zyrtar të themelimit të fondacionit në regjistrin e mbajtur pranë gjykatës sonë, pas regjistrimit një kopje e vendimit t'i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Fondacioneve për t'u regjistruar në regjistrin qendror dhe për t'u botuar në Fletoren Zyrtare.

Përfaqësuesi ligjor i kërkuesit bashkëlidhur kërkesës ka dorëzuar aktin zyrtar të themelimit të fondacionit, dëftesën bankare dhe shkresën e caktimit të përfaqësuesit.

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Fondacioneve është shqyrtuar akti i themelimit i datës 28.07.2016 dhe me numër 26964 i Zyrës Noteriale të 12-të të Ankarasë dhe është pyetur mendimi nëse ka ndonjë kundërshtim në lidhje me regjistrimin e fondacionit.



Nga përmbajtja e kërkesës, shkresës kthim përgjigje të Drejtorisë së Përgjithshme të Fondacioneve, aktit të themelimit në formën e redaktimit të miratuar nga Noteri i 12-të i Ankarasë me datë 28/07/2016 dhe me numër repertitori 26964, Akti i Themelimit të Fondacionit Turk Maarif, dëftesës bankare të Bankës Turke të Fondacioneve, Dega MEB Ankara me datë 28/07/2016 dhe e gjithë dosja u konstatua se nuk ka asnjë kufizim për regjistrimin e aktit të themelimit të fondacionit të kërkuarit, meqenëse u kuptua se shuma prej 990.000,00 TL (nëntëqind e nëntëdhjetë mijë lira turke) e ndarë në emër të fondacionit ishte e mjaftueshme që fondacioni të kryente veprimtarinë e tij, u vendos sa më poshtë për pranimin e çështjes.

VENDIM: Sikurse u arsyetua më sipër:

- 1- Me PRANIM Kërkesës, THEMELIMI i Fondacionit Turk Maarif, i cili ka një pasuri totale prej 990.000,00 TL (nëntëqind e nëntëdhjetë mijë lira turke), në bazë të aktit të me datë 28.07.2016 dhe numër repertitori 26964, të Noterit të 12-të të Ankarasë, REGJISTRIMI në regjistrin e fondacioneve që mbahet pranë gjykatës së selisë të Fondacionit Turk Maarif në përputhje me nenet 101 dhe në vijim të Kodit Civil Turk,
- 2- Në përputhje me nenin 104 të Kodit Civil të Turqisë, një kopje e vendimit dhe aktit të themelimit duhet t'i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Fondacioneve, në mënyrë që fondacioni të regjistrohet në regjistrin qendror që mbahet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Fondacioneve,
- 3- Nuk është e nevojshme të ngarkohet sërish tarifa pas zbritjes së tarifës së parapaguar,
- 4- Lënia kërkuarit e shpenzimeve gjyqësore.

Sa më sipër vendimi i dhënë, për të cilin është e hapur rruga e ankimimit, iu lexua qartazi dhe iu shpjegua sipas procedurës drejtpërdrejt përfaqësuesit ligjor të kërkuarit, avokatit Hayati Cankaloğlu. 02/08/2016

Sekretar 99751
ME NËNSHKRIM ELEKTRONIK

Gjykatës 24625
ME NËNSHKRIM ELEKTRONIK

(Vulë: Nr. 16342)

(Vulë e mëparshme: Nr. 20121)

(Vulë-Nënskrim i mëparshëm)

(Vulë-nënskrim)

(Vulë e mëparshme e palexueshme)

(Vulë: 02 Maj 2023)

(Vulë e mëparshme: 03 Gusht 2016, 24468)

(Vulë-Nënskrim i mëparshëm)

(Vulë e mëparshme: 23 Korrik 2017)

Manjola SOPOVI
Përdhënëse Zyrtare
e Gjykatës Turke
Cef: 005209047

AKTI I THEMELIMIT TË FONDACIONIT TURK MAARIF

FONDACIONI:

Neni 1- (1) Emri i fondacionit është Fondacioni Turk Maarif.

Në këtë akt zyrtar, Fondacioni Turk Maarif do të përmendet vetëm si "Fondacioni".

SELIA E FONDACIONIT:

Neni 2- (1) Selia e fondacionit do të jetë në qytetin e Stambollit, komuna Sultanahmet/Fatih, në adresën lagjia "Binbirdirek", rruga "Imran Öktem", nr. 1.

Degët dhe zyrat përfaqësuese mund të hapen jashtë vendit me vendim të Bordit Drejtues të fondacionit në kuadrin e Ligjit Turk të Fondacionit Maarif, me datë 17.06.2016 dhe me numër 6721 dhe legjislacionit përkatës.

QËLLIMI I FONDACIONIT:

Neni 3- (1) Qëllimi i fondacionit është të ofrojë bursa studimi në të gjitha fazat e arsimit nga arsimit parashkollor deri në arsimin universitar me qëllim ofrimin dhe zhvillimin e shërblimeve arsimore formale dhe joformale jashtë vendit, të bazuara në njohuritë dhe vlerat e përbashkëta të njerëzimit jashtë vendit, të hapë objekte të tilla si shkolla, institucione arsimore dhe konvikte, të trajnojë trajnerë që mund të punojnë në këto institucione, duke përfshirë edhe brenda vendit, të kryejë kërkime shkencore dhe studime kërkimore dhe zhvillimore, të publikojë dhe zhvillojë metoda dhe të kryejë aktivitete të tjera trajnimi në përputhje me legjislacionin e vendit ku operon.

AKTIVITETET E FONDACIONIT:

Neni 4-(1) Aktivitetet që do të kryejë Fondacioni për të arritur objektivat e përcaktuara në nenin 3 janë si më poshtë:

a) Në lidhje me arsimin dhe trajnimin:

- 1) Hapja e institucioneve të arsimit parashkollor, fillor, të mesëm dhe të arsimit të lartë,
- 2) Ngritja e objekteve të tilla si kurse të arsimit joformal, qendra studimi dhe qendra kulturore,
- 3) Ngritja e bibliotekave, laboratorëve, objekteve të artit dhe sportit, të cilat do të konsiderohen si pjesë përbërëse e objekteve arsimore,
- 4) Krijimi i organeve publikuese të tilla si faqet e internetit arsimore, zhvillimi, prodhimi dhe botimi i programeve dhe përmbledhjeve arsimore që konsiderohen të përshtatshme nga Ministria e Arsimit Kombëtar.

5) Ngritja e objekteve të tilla si konvikte, bujtina dhe shtëpi qëndrimi që do të plotësojnë nevojat e akomodimit të njerëzve që shërbejnë dhe marrin trajnime në institucionet arsimore.

b) Blerja, marrja në dorëzim dhe marrja me qira e objekteve të renditura në nënparagrafin (a).

c) Bashkëpunimi me institucione dhe organizata të përfshira në aktivitete të ngjashme brenda kufijve ligjorë, duke përfshirë partneritetet.

ç) Mbështetje me bursa arsimore dhe para në dorë, si dhe mbështetje me materiale edukative si fletore, libra, rroba, kompjuter dhe softuer për studentët në të gjitha fazat e arsimit nga ai parashkollor deri në universitet.

d) Kryerja e kërkimeve shkencore dhe studimeve kërkimore-zhvillimore për metodat dhe kriteret e edukimit, përmbajtjen dhe kurrikulën, si dhe mbështetja e studimeve, realizimi i botimeve periodike dhe jo periodike në këtë kuadër, organizimi i simpoziumeve, konferencave dhe seminareve, si dhe bashkëpunimi me institucionet dhe organizatat që operojnë në këtë fushë.

e) Krijimi i ambienteve të trajnimit për të trajnuar personelin që do të marrë përsipër detyra të tilla si mësimdhënie, edukim dhe konsulencë në institucionet arsimore, organizimi i programeve të trajnimit, inkurajimi i pjesëmarrjes në këto programe trajnimi në vende të ndryshme të botës, ofrimi i mundësive të tilla si bursa dhe akomodim për pjesëmarrësit, mbështetja financiare e institucioneve dhe organizatave që operojnë në këtë fushë duke bashkëpunuar me to kur është e nevojshme.

f) Pranimi i ndihmave financiare dhe në natyrë nga brenda dhe jashtë vendit për kryerjen e aktiviteteve të përcaktuara në nënparagrafët (a) dhe (e) dhe organizimi i aktiviteteve brenda kuadrit të qëllimit të saj, ngritja e bizneseve që gjenerojnë të ardhura brenda dhe jashtë vendit dhe partneriteti me bizneset ekzistuese.

(2) Fondacioni mund t'i kryejë këto aktivitete vetëm ose në partneritet me persona juridikë ose realë. Fondacioni gjithashtu mund të kryejë aktivitete vetëm me qëllim promovimi, të marrë pjesë në aktivitete të përbashkëta ose të mbështesë aktivitete të tilla kur është e nevojshme. Gjithashtu, në rast nevojë, krijimi ose marrja me transferim e shoqërive me personalitet juridik të së drejtës private për kryerjen e të gjitha ose një pjese të këtyre veprimtarive të renditura në këtë nen nëpërmjet këtyre shoqërive.

(3) Në qytetet jashtë shtetit ku hapen institucionet e arsimit formal dhe joformal nga Fondacioni, institucionet dhe organizatat e tjera publike nuk mund të krijojnë njësi të tjera për të njëjtin qëllim.

PUNËT DHE PROCEDURAT QË MUND TË KRYEJË FONDACIONI PËR TË REALIZUAR QËLLIMIN E TUJ:

Neni 5- (1) Fondacioni për të arritur qëllimin e tij, sikurse përcaktohet në nenin 48 të Kodit Civil Turk, është i autorizuar dhe ka tagre të zotërojë dhe të përdorë prona të luajtshme dhe të paluajtshme përmes donacioneve, testamenteve, blerjeve dhe qirave, të shesë, të transferojë dhe të heq dorë nga pronat e tij në përputhje me ligjin nr. 6721 dhe dispozitat e ligjit për fondacionet, të marrë dhe shpenzojë të ardhurat e tij, të përdorë një ose më shumë pasuri të paluajtshme ose të ardhura në asetet e fondacionit në një ose më shumë investime, të administrojë dhe të kursejë dhurimet dhe trashëgimitë, pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, që i ka siguruar nëpërmjet blerjes ose me rrugë të tjera, si dhe shumat monetare, me kusht që ato të mos jenë në kundërshtim me qëllimin dhe objektin e shërbimeve të fondacionit, të blejë letra me vlerë dhe t'i vlerësojë dhe shesë ato në përputhje me qëllimin e fondacionit, të bashkëpunojë, të marrë ndihmë, të ndihmojë me fondacione, persona realë dhe juridikë brenda dhe jashtë vendit që kryejnë veprimtari të ngjashme me qëllimet e fondacionit, të bëjë marrëveshje për të ofruar këtë ndihmë, të pranojë të drejta reale të ndryshme nga pasuria si servituti, uzufukti, banimi, ndërtimi, pengu, hipoteka e pasurisë së paluajtshme, të përdorë këto të drejta, të marrë të gjitha llojet e garancive, duke përfshirë pengun dhe hipotekën e mallrave të luajtshme dhe të paluajtshme, për kontratat që do të lidhen me të ardhurat e tyre aktuale ose të ardhshme, të pranojë garanci bankare të vlefshme, të marrë hua kur është e nevojshme për të realizuar qëllimin dhe subjektet e shërbimit të fondacionit, të japë garanci, të vendosë peng, kolateral e të tjera, të gjenerojë të ardhura nga projektet dhe të gjitha llojet e punëve të kryera dhe që do të kryhen në përputhje me qëllimin dhe çështjet e shërbimit të fondacionit dhe të krijojë operacione ekonomike dhe shoqëri që do të operojnë sipas parimeve të zakonshme të funksionimit për të gjeneruar të ardhura për fondacionin, të

marrin pjesë në partneritet e krijuara, t'i operojnë ato drejtpërdrejt ose t'i operojnë ato nga një operator nën kontrollin e tyre, të lidhë kontrata për iniciativa, kurse, blerje, ndërtime dhe aktivitete të ngjashme që vlerësohen të dobishme dhe të nevojshme për realizimin e një ose të të gjitha qëllimeve dhe çështjeve të shërbimeve të fondacionit. Fondacioni nuk mund t'i përdorë këto kompetenca dhe të ardhura për qëllime të ndaluara nga Kodi Civil Turk.

(3) Në realizimin e shërbimeve të biznesit të përcaktuara në nenet 3 dhe 4 të aktit, Fondacioni bashkëpunon në forma të ndryshme me persona vullnetarë dhe institucione, përfiton nga idetë, punët, koha, interesi, informacioni, pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të tyre, etj. Dhe i shpalos atyre mundësitë.

ASETET E FONDACIONIT:

Neni - 6 (1) Në përputhje me procedurën e përcaktuar në paragrafin e dytë të dispozitës kalimtare të 1-rë të ligjit nr. 6721, asetet e themelimit të Fondacionit pasi shpenzimet e themelimit të jenë zbritur nga buxheti i Ministrisë së Arsimit Kombëtar i dedikuar për Fondacionin, 990.000.-TL (nëntëqind e nëntëdhjetë mijë lira turke) do t'i transferohen Fondacionit.

Asetet e themelimit mund të rriten me shtesat që do t'u bëhen aktiveve pas krijimit të fondacionit.

ORGANET E FONDACIONIT:

Neni 7- (1) Organet e fondacionit janë paraqitur më poshtë.

- a) Bordi i Administrimit,
- b) Bordi Drejtues.
- c) Bordi Mbikëqyrës.

BORDI I ADMINISTRIMIT:

Neni 8- (1) Bordi i Administrimit të Fondacionit përbëhet nga dymbëdhjetë anëtarë. Ai përbëhet nga shtatë anëtarë të përhershëm, katër prej të cilëve emërohen nga Presidenti i Republikës dhe tre nga Këshilli i Ministrave, dhe dy prej tyre janë përfaqësues të Ministrisë së Arsimit Kombëtar, përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Financave dhe Këshillit të Arsimit të Lartë. Personat realë dhe përfaqësuesit e personave juridikë që marrin pjesë në themelimin e Fondacionit përbëjnë Bordin e Administrimit të Fondacionit.

(2) Anëtarët e Bordit të Administrimit të Fondacionit zgjidhen nga të diplomuarit e fakultetit të paktën katërvjeçare dhe mund të marrin detyrën deri në fund të moshës shtatëdhjetë e dy vjeç.

(3) Anëtarët e përhershëm të Bordit të Administrimit zgjedhin midis anëtarëve të përhershëm një kryetar dhe nënkryetar për një mandat pesëvjeçar me votim të fshehtë. Në rast se mbaron mandati i Kryetarit të Bordit të Administrimit, përfundon edhe mandati i zëvendëskryetarit.

(4) Në rast se Kryesia e Bordit të Administrimit shbëhet për çfarëdo arsye, ajo mbledhet nën kryesimin e anëtarit të përhershëm më të vjetër deri në zgjedhjen e kryetarit të ri dhe zgjedhjet për pozicionin e kryetarit bëhen me shumicën absolute të numrit të anëtarëve të përhershëm për vendin vakant.

(5) Në rast se anëtarësimet e përhershme mbeten vakante për shkak të vdekjes, dorëheqjes ose ndonjë arsye tjetër, anëtarët e përhershëm zgjedhin anëtarë të rinj për anëtarësimet vakante me shumicë absolute. Në rast të barazisë në votën zgjedhore për Anëtarësim të Përhershëm, vota e kryetarit konsiderohet përcaktuese për shumicën e votave.

DETYRAT DHE KOMPETENCAT E BORDIT TË ADMINISTRIMIT:



Neni -9 (1) Bordi i Administrimit është organi më i lartë vendimmarrës i fondacionit. Kompetencat e Bordit të Administrimit janë paraqitur më poshtë;

- a) Zgjedhja e Bordit Drejtues,
- b) Zgjedhja e Bordit Mbikëqyrës,
- c) Disktimi dhe shqyrtimi i raportit të veprimtarisë i përgatitur nga Bordi Drejtues i fondacionit dhe raportet e këshillit mbikëqyrës, marrja e vendimit për lirim të Bordit Drejtues,
- ç) Miratimi i drafteve të akteve ligjore të brendshme që do të përgatiten nga Bordi i Administrimit ashtu siç janë ose duke i ndryshuar ato,
- d) Pranimi i drafteve të buxhetit vjetor që do të përgatiten nga Bordi Drejtues ashtu siç janë ose duke i ndryshuar ato,
- e) Përcaktimi i shumës së tarifës së pjesëmarrjes që do t'u jepet anëtarëve të Bordit Drejtues dhe mbikëqyrës,
- f) Kryerja e shtesave dhe ndryshimeve në aktin e themelimit kur është e nevojshme,
- g) Bordi Drejtues përcakton dhe ndjek politikën e përgjithshme në lidhje me aktivitetet e Fondacionit,
- h) Pranimi i donacioneve, trashëgimive dhe donacioneve në përputhje me qëllimin në mënyrë që të sigurohet që fondacioni të arrijë qëllimin e tij, blerj, marrja me transferim, shitja, marrja me qira, dhënia me qira, vënia në operim vetë ose nëpërmjet të tjerëve i të gjitha llojeve të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme me lejen e organeve kompetente, themelimi i shoqërive tregtare, partneriteti në shoqëritë tregtare të themeluara dhe zgjedhja e përfaqësuesit të Fondacionit pranë shoqërive dhe kompanive,
- j) Transferimi dhe blerja e të gjitha llojeve të të drejtave me vlerë financiare ose transferimi i tyre të të tjerët dhe njohja e të drejtës së tjetërsimit në lidhje me to,
- k) Kryerja e të gjitha llojeve të transaksioneve dhe aktiviteteve që janë në përputhje me qëllimin e Fondacionit dhe që do t'i sjellin përfitime Fondacionit,
- l) Miratimi i vendimeve të marra nga Bordi i Administrimit për ndërprerjen e punës së personelit, kur është e nevojshme, në përputhje me dispozitat e legjislacionit,
- m) Krijimi i kuadrove të reja në varësi të Bordit Drejtues kur është e nevojshme dhe pranimi dhe miratimi i emërimeve të paraqitura nga Bordi Drejtues,
- n) Miratimi i bilancit, llogarisë së të ardhurave-shpenzimeve, raportit të punës, programeve vjetore dhe buxhetit të përkohshëm të përgatitur nga Bordi Drejtues.

(2) Bordi i Administrimit mund të kryejë vetë detyrat e përcaktuara në këtë nen, ose mund t'i transferojë disa nga këto detyra tek Bordi Drejtues duke përcaktuar kufijtë.

(3) Vendimet në lidhje me qëllimin e Fondacionit për vendimet politike, planin strategjik, buxhetin dhe investimet merren me kusht që të jenë të pranishëm Kryetari i Bordit të Administrimit ose Zëvendëskryetari.

KOHA E MBLEDHJES DHE KUORUMI I VENDIMEVE TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT;

Neni 10- (1) Mbledhja e parë e Bordit të Administrimit mbahet brenda një muaji pas regjistrimit të fondacionit.

a) Bordi i Administrimit mblidhet të paktën katër herë në vit nën kryesimin e Presidentit të Fondacionit me shumicën absolute të numrit të përgjithshëm të anëtarëve dhe merr vendime me shumicën absolute të të pranishmëve.

Në rast të barazisë së votave, vota e dhënë nga presidenti është përcaktuese për shumicën e votave. Kryetari i delegacionit dhe anëtarët e përhershëm të delegacionit nuk mund të abstenojnë.

Mbledhja e jashtëzakonshme mbahet drejtpërdrejt me ftesë të Kryetarit të Bordit të Administrimit. Mbledhje e jashtëzakonshme mbahet edhe me kërkesë me shkrim të anëtarëve të Bordit të Administrimit ose shumicës absolute të anëtarëve të Bordit të Administrimit.

Manjola SOPOL
Përdhlyese Zyrtar
e Gjykatës Turke
Ceh. 05E2019/142



Kërkesat e anëtarëve për mbledhje të jashtëzakonshme trajtohen nëse anëtarët njoftohen me shkrim ose elektronikisht të paktën dhjetë ditë para mbledhjes.

(b) Ai mbledhet në një kohë të paracaktuar gjatë vitit për të diskutuar miratimin e bilancit, buxhetit dhe raporteve të punës.

(2) Çështjet që nuk përfshihen në rendin e ditës të shpallur nuk mund të diskutohen në mbledhje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme. Megjithatë, është e mundur të shtohet një pikë në rendin e ditës me propozimin me shkrim të të paktën një të tretës së të pranishmëve, menjëherë pas formimit të këshillit në mbledhjen e zakonshme, me përjashtim të çështjeve që do të vendosin ndryshimin e aktit të themelimit dhe që sjellin detyrime dhe përgjegjësi për de organet e e fondacionit dhe fondacionin.

(3) Data, vendi dhe rendi i ditës së mbledhjes komunikohet në adresat e tyre me letër rekomande përkundrejt nënshkrimit ose korrespondencë elektronike të paktën shtatë ditë para ditës së mbledhjes.

(4) Një anëtar që nuk mund të marrë pjesë në mbledhje mund të emërojë si përfaqësues një anëtar tjetër të Bordit të Administrimit. Në një person të vetëm nuk mund të mbledhen më shumë se një procure përfaqësimi.

(5) Anëtarësimi i një anëtari që nuk merr pjesë në mbledhjet e Bordit të Administrimit tri herë radhazi ose pesë nga dhjetë mbledhjet e fundit pa arsye, ndërpritet.

(6) Anëtarët e Bordit të Administrimit sigurojnë një adresë korrespondence elektronike menjëherë pas zgjedhjes së tyre. Kjo adresë i raportohet Bordit të Administrimit dhe, nëse shihet e nevojshme, mund të bëhen njoftime në këto adresa.

BORDI DREJTUES:

Neni 11- (1) Bordi Drejtues është organi ekzekutiv i Fondacionit dhe ka autoritetin për të përfaqësuar Fondacionin. Bordi Drejtues përbëhet nga një kryetar dhe gjashtë anëtarë. Anëtarët e Bordit Drejtues dhe kryetari emërohen nga Bordi i Administrimit për një periudhë pesëvjeçare dhe anëtarët e emëruar mund të shkarkohen nga Bordi i Administrimit kur është e nevojshme. Bordi i Administratorëve mund të zgjedhë anëtarët e Bordit Drejtues nga brenda ose nga jashtë. Anëtarët e Bordit Drejtues përzgjidhen nga ata që janë dalluar në fushën e drejtësisë, financës, komunikimit, arsimit, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe menaxhimit të arsimit. Çdo anëtar i Bordit Drejtues në të njëjtën kohë është edhe drejtues i njësisë në varësi të tij.

(2) Bordi Drejtues përbëhet nga njësitë e mëposhtme:

- a) Planifikimi Strategjik dhe Politikat e Investimeve,
- b) Menaxhimi i Ndërmarrjeve Institucionale dhe Ekonomike,
- c) Politikat dhe Kurrikula Arsimore,
- d) Trajnimi i Trajnerëve dhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore,
- e) Procedurat e Ndjekjes së Studentëve dhe të Diplomuarve,
- f) Shërbimet e Vlerësimit të Legjislacionit dhe Auditimit.

(3) Në mbledhjen e parë të Bordit të Administrimit zgjidhet kryetari dhe llogaritari dhe bëhet ndarja e detyrave. Bordi i Administrimit, në përputhje me përcaktimet e paragrafit 1, bën emërimi e një anëtari, në vend të anëtarit, të cilit për çfarëdo arsye i ndërpritet anëtarësia në Bordin e Administrimit përpara përfundimit të mandatit të tij.

Bordi Drejtues mbledhet të paktën një herë në muaj. Anëtarësimi i një anëtari që nuk merr pjesë pa arsye në tri mbledhje radhazi të Bordit Drejtues ose pesë nga dhjetë mbledhjet e fundit përfundon.

Bordi i Administrimit mbledhet me shumicën absolute të numrit të përgjithshëm të anëtarëve dhe merr vendime me shumicën absolute të pjesëmarrësve në mbledhje. Në rast të barazisë së votave, vota e shënë nga presidenti përcakton shumicën e arritur të votave. Kryetari dhe

anëtarët e Bordit Drejtues nuk mund të abstenojnë nga votimi. Vendimet e marra shkruhen në librin e vendimeve të noterizuara dhe nënshkruhen.

(4) Anëtarët e Bordit Drejtues do të pajisen me një adresë korrespondence elektronike menjëherë pas zgjedhjes së tyre. Kjo adresë i raportohet Bordit të Administrimit dhe, nëse shihet e nevojshme, mund të bëhen njoftime në këto adresa.

DETYRAT, KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E BORDIT DREJTUES:

Neni 12- (1) Bordi Drejtues është organi administrativ dhe ekzekutiv i fondacionit.

Në këtë cilësi, Bordi Drejtues:

- a) Merr dhe zbaton të gjitha llojet e vendimeve në përputhje me qëllimin e fondacionit.
- b) Në dritën e politikave të përgjithshme që ka përcaktuar, ai siguron që aktivitetet e fondacionit të kryhen rregullisht dhe me efikasitet. Në këtë kuadër përgatit draftet e nevojshme të legjislacionit vendas dhe të huaj dhe ia paraqet për miratim Bordit të Administrimit.
- c) Kryen studimet e nevojshme për vlerësimin e pasurisë së fondacionit dhe marrjen e burimeve të reja financiare.
- d) Në emër të personit juridik të fondacionit bën iniciativat dhe transaksionet e nevojshme me të gjithë personat realë dhe juridikë për çështje juridike, financiare dhe të tjera.
- e) Me kusht që detyrat, autorizimet dhe përgjegjësitë të përcaktohen qartë paraprakisht, mund të krijojë sekretariatën e përgjithshëm të fondacionit ose njësi ndihmëse të ngjashme, dhe kur është e nevojshme, mund të ndërpresë detyrat e tyre.
- f) Përcakton personelin që do të punësohet në Fondacion, bën takimet, përcakton pagat e tyre dhe përfundon punësimin e tyre kur është e nevojshme.
- g) Vendos për hapjen dhe mbylljen e degëve dhe përfaqësive jashtë vendit, në kuadrin e dispozitave të legjislacionit përkatës, merr veprimet e nevojshme në këtë drejtim.
- h) Monitoron dhe kontrollon proceset kontabël të fondacionit, siguron që pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe bilanci të përgatiten në fund të periudhës kontabël dhe të dërgohen në administratën përkatëse dhe të shpallen.
- i) Kryen përgatitjet për mbledhjet e Bordit të Administrimit.
- j) Në mbledhjet e Bordit të Administrimit, paraqet raportin vjetor të periudhës.
- k) Kryen detyra të tjera të kërkuara nga Ligji për Fondacionin Turk Maarif dhe legjislacioni përkatës, akti i themelimit dhe legjislacioni i brendshëm i fondacionit.
- l) Përgatit planin strategjik të fondacionit dhe ia paraqet atë për miratim Bordit të Administrimit.
- m) Përgatit bilancin, kontabilitetin e të ardhurave-shpenzimeve, raportin e punës dhe programet vjetore dhe buxhetin e përkohshëm.
- n) Zbaton buxhetin vjetor të pranuar nga Bordi i Administrimit.
- p) Kur është e nevojshme, krijon komitete ose grupe pune të përkohshme ose të përhershme shkencore dhe teknike dhe kryen kërkime.

(2) Bordi Drejtues mund të kryejë vetë detyrat e përcaktuara në këtë nen, ose mund t'i delegojë disa nga këto detyra njërive që do të formohen ose anëtarëve ndihmës duke përcaktuar kufijtë.

PËRFAQËSIMI I FONDACIONIT:

nENI 13- (1) Bordi drejtues përfaqëson fondacionin. Bordi Drejtues mund t'ia delegojë këtë autoritet përfaqësimi kryetarit të Bordit Drejtues. Bordi Drejtues në përgjithësi ose në raste dhe çështje të caktuara është i autorizuar të lidhë çdo kontratë, të lëshojë dhe transferojë kontrata, dokumente ligjore ose akte në emër dhe për llogari të Fondacionit, brenda parimeve që do të specifikojë, tek një ose më shumë anëtarë të tij, tek nëpunësi i autorizuar, tek një ose më shumë nga nëpunësit e autorizuar të tij, tek përfaqësuesit ose përfaqësitë e tyre.

BORDI MBIKQYRËS:

nENI 14- (1) Bordi Mbiqëqyrës kontrollon aktivitetet dhe llogaritë e Fondacionit në emër të Bordit të Administrimit. Bordi Mbiqëqyrës përbëhet nga pesë anëtarë të përhershëm dhe pesë anëtarë zëvendësues të emëruar nga Bordi i Administrimit për një periudhë pesëvjeçare. Në formimin e Këshillit Mbiqëqyrës përfshihen përfaqësues të Ministrisë së Arsimit Kombëtar dhe Ministrisë së Financave.

(2) Një anëtar zëvendësues thirret në detyrë në vend të një anëtari të përhershëm që largohet për çfarëdo arsye.

(3) Këshilli mbiqëqyrës kryen verifikimet e tij për të gjitha librat, regjistrat dhe dokumentet. Raporti që do të përgatitet në periudhën kontabël i dorëzohet Bordit Drejtues për t'iu dërguar Bordit të Administrimit të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para mbledhjes së Bordit të Administrimit.

E DREJTA E IMUNITETIT:

Neni 15- (1) Tarifat, shtesat dhe dietat e udhëtimit dhe të drejtat e tjera personale që do t'u paguheshin organeve të Fondacionit të listuara në këtë ligj dhe njësive të reja që do të formohen me aktin e themelimit të Fondacionit përcaktohen nga Bordi i Administrimit.

(2) Personat që punojnë në organet e Fondacionit përfitojnë nga të drejtat që u njihen konsulentëve të punësuar pranë përfaqësive të huaja të Republikës së Turqisë, sipas nenit 13 të ligjit për pasaportat me nr. 5682, datë 15.7.1950.

BUXHETI DHE TË ARDHURAT E FONDACIONIT TURK MAARIF, AMNISTIMET, PËRJASHTIMET DHE ZBRITJET:

Neni 16- (1) Fondacioni bën një buxhet vjetor në përputhje me qëllimet dhe aktivitetet e tij. Periudha kontabël buxhetore është viti kalendarik. Fondacioni rezervon maksimumi një të tretën e të ardhurave të tij bruto gjatë vitit për personelin që punon në detyrat financiare, administrative, ligjore dhe ndihmëse, shpenzimet dhe rezervat e menaxhimit dhe mirëmbajtjes; Dy të tretat e mbetura shpenzohen dhe ndahen për qëllimet e Fondacionit, për personelin që punon për të arritur këto qëllime dhe për investitorët që do të rrisin asetet e tij. Përveç kësaj, Fondacioni mund të krijojë, të marrë përsipër dhe të bëhet partner në sipërmarrjet ekonomike ose kompanitë kapitale në Turqi dhe jashtë saj për të arritur objektivat e tij.

(2) Të ardhurat e fondacionit janë si më poshtë:

a) Të gjitha llojet e donacioneve dhe ndihmave të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara, përfshirë grantet e transferuara nga fondet kombëtare dhe ndërkombëtare në përputhje me qëllimin e Fondacionit.

b) Të gjitha llojet e produkteve, shërbimeve vendase dhe të huaja, dhurime të luajtshme, të paluajtshme, të ardhura dhe testamente dhe ndihma në natyrë dhe në para.

c) Të ardhura të ndryshme nga aktivitetet e fondacionit.

ç) Të ardhurat nga ndërmarrjet ekonomike, filialet dhe partneritet.

d) Të ardhurat e krijuara nga vlerësimi i pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të fondacionit dhe të drejtave të tjera.

e) Shumat që do të transferohen nga buxheti i përgjithshëm dhe institucionet dhe organizatat publike përkatëse me vendim të Këshillit të Ministrave.

f) Të ardhura të tjera.

(3) Fondacioni është i përjashtuar nga:

a) Tatimi mbi korporatat (me përjashtim të ndërmarrjeve ekonomike dhe filialeve),

b) Taksa e trashëgimisë dhe dhuratave për shkak të donacioneve dhe ndihmave,

c) Tarifat për transaksionet e kryera për shkak të aktiviteteve të saj të renditura në këtë ligj, tatimit mbi pullën për shkresat e lëshuara në këtë fushë, dhe tatimit mbi pasurinë e paluajtshme për pasuritë e paluajtshme që zotëron.

(4) Fondacionet të cilave u njihet përjashtimi tatimor nga Këshilli i Ministrave përfitojnë përjashtime nga taksat, detyrimet dhe tarifatat e parashikuara nga ligje të tjera.

(5) Donacionet dhe ndihmat për fondacionin zbriten nga baza e tatimit mbi të ardhurat dhe korporatat.

NDRYSHIMI I AKTIT ZYRTAR TË THEMELIMIT:

Neni 17- (1) Ndryshimi i aktit për çështje që nuk rregullohen nga dispozitat e ligjit nr. 6721, bëhet me propozimin me shkrim të të paktën gjysmës (1/2) së Bordit Drejtues ose anëtarëve të ordit të administrimit dhe miratimin e të paktën dy të tretave (2/3) të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Bordit të Administrimit, duke përfshirë të paktën pesë anëtarë të përhershëm, dhe ëhet me vendim të gjykatës.

MBYLLJA FONDACIONIT:

Neni 18- (1) Në rast se fondacioni mbyllet për çfarëdo arsye, pasuritë dhe të drejtat e mbetura nga likuidimi i borxheve i kalojnë Ministrisë së Arsimit Kombëtar.

Mbyllja e fondacionit është e mundur vetëm me propozimin me shkrim të të paktën më shumë se gjysmës së numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Bordit Drejtues ose të Bordit të Administrimit, me miratimin e tre të katërtave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Bordit të Administrimit (3/4) dhe vendimi merret nga gjykata.

DISPOZITA KALIMTARE:

Nen kalimtar -1 Ministria e Arsimit Kombëtar është autorizuar të kryejë të gjitha procedurat e nevojshme për regjistrimin e fondacionit.

Ministria e Arsimit Kombëtar është e detyruar të thërrasë në mbledhje Bordin e Administrimit jo më vonë se brenda një muaji nga data e regjistrimit të fondacionit dhe ka detyrat dhe kompetencat e përcaktuara në akt brenda kësaj periudhe.

Shënim i përkthyeses:

- Dokumenti në fillim të çdo faqe mban:

1 vulë të mëparshme: Nr. 26964

1 vulë të mëparshme: Nr. 20121

- Dokumenti në fundin e çdo faqe mban:

1 vulë të mëparshme me shënimin: Në kopjen origjinale ka nënshkrim.

1 vulë dhe nënshkrim i mëparshëm i Zyrës Noteriale.

1 vulë të njomë: Nr. 16342

1 vulë të njomë dhe nënshkrim të Zyrës Noteriale.

1 vulë të njomë: 02 Maj 2023.

1 vulë dhe nënshkrim të mëparshëm.



REPUBLIKA E TURQISË
LETËRNJOFTIM

Fotografia

| | | | |
|---|--|---|-------------------------------------|
| Seri dhe Numri i Kartës së Identitetit | | | |
| SERIA T13 NR. 898633 | | | |
| T E D H E N A T E P E R S O N I T | Numri i Letërnjoftimit si Republikës së Turqisë 39089051016 | Gjenera Mashkull | |
| | Mbiemri YILMAZ | Emri ISMET | |
| | Atësi IBRAHIM | AMESIA TURUNÇ | |
| | Vendi i Lindjes GUNES | Data e Lindjes 10.12.1961 | |
| | Gjendja Civile I MARTUAR | Feja ISLAME | Grupi i Gjokut |
| Mbiemri i Mëparshëm (i Vajzërta) | | | |
| R E G J S T R U A R | Qyteti SIVAS | Komuna GÜRÜN | |
| | Lagja/Fshati FSHATI GÜNEŞ | Vëllimi Nr. 0039 | Radha Familjare Nr. 00010 |
| L E S H U A R | Vendi i Lëshimit ÇANKAYA | Arsyeya e Lëshimit HUMBUR | |
| | Nr. Regjistrimit 18783 | Data e Lëshimit 31.05.2016 | |
| A U T O R I T E T I | Emri Mbiemri dhe Titulli CEMAL DURULMUŞ Punonjës i Përgatitjes dhe Kontrollit të të Dhënave (Firma) | Vila MUSTAFA GÜNGÖRLÜ Drejtor i Gjendjes Civile (Firma-Vila) | |
| | Firma dhe Data (Firma) | | |
| Mbiemri i Mëparshëm | | | |



Shënim i përkthyeses:

- Dokumenti në mesin e tij mban:

1 vulë të mëparshme: 28 Korrik 2016

1 vulë të mëparshme: Nr. 26964

- Dokumenti në fundin e tij mban:

1 vulë dhe nënshkrim të mëparshëm të Zyrës Noteriale.

1 Vulë me shënimin: Është dokument shoqërues, nuk mund të përdoret më vete.

1 vulë të mëparshme: Nr. 20121.

1 vulë të njomë: Nr. 16342.

1 vulë dhe nënshkrim të njomë të Zyrës Noteriale.

1 vulë të njomë: 02 Maj 2023.

1 vulë dhe nënshkrim të mëparshëm.

Marigole SOPOTI
Përkthyes Zyratari
e Gjuhës Turke
Cel: 06820904

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER DENISA ÇELA



V2023053750140022782

DATE 10/05/2023
NR REP 1623



VËRTETIM PËRKTHIMI

Sot, më datë 10/05/2023, para meje Notere DENISA ÇELA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën NJESIA BASHKIAKE NR. 10, RR. RESHIT ÇOLLAKU, GODINA NR.7, APARTAMENTI NR.91, HYRJA NR.7, u paraqit personalisht:

PËRKTHYESE:

Manjola Sopoti, atësia Flamur, amësia Fiqirete, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë E Kavajës; Nd. 225; H. 2; Ap. 20; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 23/03/1976, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033821295 dhe nr. personal H65323146W.

Përkthyesja është i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, e cila më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur "*Njesia me Originalin, Akti i Themelimit te Fondacionit ne Formen e Redaktimit*" se bashku me *Apostile*, nga gjuha Turke në gjuhën Shqipe dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noteres.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë;" në Republikën e Shqipërisë unë Noterja vërtetohet nënshkrimi i përkthyeses.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE
DENISA ÇELA